



Programi Vjetor i Punës - DPS

PVP: [12.02.2024](#)MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT

Plani Operacional i punës për vitin 2024				
Objektivat	Produkti dhe masat	Afati	Indikatorët	Njësia përgjegjëse
I. Progresi në procesin e anëtarësimit të DPS në organizmat europiane e ndërkombëtare të standardizimit – Kap.1	<p>Shqyrtimi i <i>acquis</i> së BE dhe krahasimi me përputhshmërinë ose jo të legjislacionit vendas për standardizimin dhe fushat që lidhen me të;</p> <p>Përgatitja e raporteve/progresit për CEN&CENELEC dhe pjesëmarrja në raportimet për KE mbi zhvillimet në këtë fushë dhe proceset e integrimit</p> <p>Komunikimet me CEN&CLC lidhur me realizimin e Planit të Veprimit (PV) për masat korigjuese të dakordësuar me raportin e auditit të CEN&CENELEC, mbi kriteret për anëtarësim me të drejtë të plota në këto organizma.</p> <p>Pjesëmarrja në takimet me ekspertë të Komisionit European, përgatitja, raportimi dhe dërgimi i informacioneve në fushën e standardizimit. Puna me Roadmap dhe GNIP për kap.1, 20, 28</p>	Janar-Dhjetor 2024 Janar 2024 e në vazhdim	<p>Veprimtaria e Standardizimit në vend kryhet në përputhje dhe bazuar në legjislacionin vendas, i cili ka transpozuar <i>acquis</i> dhe praktikat Evropiane në këtë fushë.</p> <p>Rregulloret dhe procedurat e punes se DPS, të ndryshuara në përputhje me ato të CEN/CENELEC;</p> <p>Plotësimi, në bashkëpunim me MEKI, i detyrave të lëna në PV/CEN&CLC dhe evidentimi/raportimi i tyre, përfshi edhe shtimin e stafit të DPS sic kërkohet në këtë PV.</p> <p>Përgatitja e materialeve/informacioneve mbi progresin periodik në fushën e standardizimit</p> <p>Kërkesa (deri në dhjetor 2024) për ri-auditim nga CEN&CENELEC mbi plotësimin nga ana e DPS e non-konformiteteve të lëna për plotësim në PV/CEN/CLC</p>	DPS në bashkëpunim me MEKI



Programi Vjetor i Punës - DPS

Versioni 03

Faqa 1/8

	Organizimi i dy mbledhjeve të Bordit Drejtues të DPS në zbatim të ligjit 9870/2008, të ndryshuar dhe VKM 433/2010, të ndryshuar	Mars - Dhjetor 2024	Miratimi i Planit vjetor të DPS për vitin 2024 dhe diskutimi/miratimi i ndryshimeve në Bordin Teknik (sipas rastit nëse ka).	Bordi Drejtues i DPS dhe Sekretaria e Bordit
II. Adoptimi i rreth 96% të totalit të standardeve të CEN/CENELEC, 90% të ETSI, 20% të IEC dhe 24% të ISO dhe shfuqizimi i standardeve të zëvëndësuara	950 standarde te (600 CEN, 350 CENELEC) të adoptuara si SSH; 375 standarde të ETSI të adoptuara si SSH; 150 Standarde të IEC të adoptuara si SSH; 225 standarde ISO të adoptuara si SSH.	Janar - Dhjetor 2024	Venia në dispozicion të biznesit dhe çdo grapi tjetër interesit të standardeve evropiane dhe ndërkombëtare në fuqi si dokumenta shqiptare për zbatim. Organizimi i mbledhjeve të Komiteteve Teknike të DPS-së (KT) për shqyrtimin, adoptimin, shfuqizimin dhe miratimin e standardeve shqiptare (SSH) për të gjitha fushat e ekonomisë, elektroteknikës dhe telekomunikacionit. Kontrolli periodik dhe plotësimi në Sistemin e Menaxhimit të Standardeve (SMS) me të dhënat e standardeve dhe dokumenteve të standardizimit të reja. (kodi, ICS, referencat, direktiva, titulli në anglisht, titulli në shqip, fusha e zbatimit në gjuhën shqipe, fazat përkatëse në të cilat kalon standardi ose dokumenti që në fazën e parë ku regjistrohet si projektstandard deri kur merr statusin i publikuar, nr i faqeve, data e publikimit, nr i vendimit, etj.) si dhe publikimi i tyre në Katalogun online të Standardeve Shqiptare.	Drejtoria e Standardeve (DS), Komitetet Teknike (KT)



Programi Vjetor i Punës - DPS

Versioni 03

Faqa 1/8

	<p>Shfuqizimi i st.të zëvëndësuara (puro SSH, si dhe EN e ISO/IEC).</p> <p>Mbajtja e 2 mbledhjeve të Bordit Teknik të DPS</p>	<p>Shkurt 2024 Korrik 2024</p>	<p>Adoptimi 100% i standardeve të harmonizuara si standarde shqiptare të harmonizuara. Shfuqizimi i standardeve puro shqiptare (SSH) të cilat janë zëvëndësuar me standarde evropiane (EN) ose ndërkontinentale (ISO), si dhe ndjekja e shfuqizimeve të standardeve nëpërmjet organizmave evropiane dhe ndërkontinentale duke ndjekur “ciklin e jetës” së standartit</p> <p>Miratimi i Programit të Punës për adoptimin e standardeve. Rishikimi i listës së standardeve dhe pjesëmarrjeve në KT</p>	<p>Drejtoria e Standardeve dhe Bordi Teknik</p>
III. Sigurimi i transparencës dhe informimit të publikut të gjerë për standardet dhe aktivitetet në fushën e standardizimit	<p>Publikimi i 4 Buletinëve informativë;</p> <p>Publikimi i Programit të Punës për titujt e rindërtuar të draftstandardeve;</p> <p>Përgatitja e njoftimeve dhe notifikimi i tyre në CEN dhe CENELEC për standarde të reja kombëtare (adoptimin e EN si SSH);</p> <p>Përgatitja e njoftimeve dhe notifikimi në Sekretariatin e OBT dhe CEFTA për pr/standarde përfshirë rregullat teknike;</p>	<p>Janar - Dhjetor 2024</p> <p>6 mujori parë 2024</p> <p>Çdo muaj</p> <p>Janar e në vazhdim 2024</p>	<p>Informimi i qytetarëve;</p> <p>Marrja e mendimit/komenteve për draftstandarde dhe kryerja e notifikimeve në zbatim të VKM 190/13.3.2012 dhe VKM 382/2018, të ndryshuar dhe rregullore të brendëshme dhe procedurave të punës</p> <p>Kryerja e notifikimeve në zbatim të VKM 789/2009 “Për notifikimet në zbatim të Marrëveshjeve të OBT /TBT dhe OBT /SPS” dhe VKM 382/2018, të ndryshuar</p>	<p>Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun (DÇLMP)</p> <p>DS</p> <p>DÇLMP</p>



Programi Vjetor i Punës - DPS

Versioni 03

Faqa 1/8

	Dhënia e mendimit dhe komentet në projekt aktet ligjore e nënligjore që vijnë nga ministritë e linjës	Janar e në vazhdim 2024	Kryerja e notifikimeve në zbatim të VKM 789/2009 “Për notifikimet në zbatim të Marrëveshjeve të OBT /TBT”, të kërkuara nga ministritë e linjës	DÇLMP
IV. Rritja e ndërgjegjësimit të operatorëve ekonomikë vendas dhe konsumatorit për rolin dhe rëndësinë e përdorimit të standardeve europiane në produktet e shërbimet e ofruara në treg dhe pjesëmarrjen e tyre në procesin e standardizimit	<p>Takime me palë të interesuara për standarde e fushave të ndryshme të ekonomisë;</p> <p>Përgatitja dhe publikimi i 100 ekstrakteve të fushave të standardeve; 40 artikujve dhe njoftimeve sensibilizuese mbi përdorimin e standardeve me interes për ekonominë dhe mbrojtjen e konsumatorit për publikim në faqen zyrtare të DPS eee.dps.gov.al dhe në rrjetet e saj sociale;</p> <p>Ri-formatimi në format elektronik i 30 standardeve të vjetra shqiptare që janë në fuqi dhe hedha në SMS e DPS të këtyre standardeve;</p> <p>Shitja e 600 SSH bazuar në kërkesat e ardhura dhe marrëveshjet e DPS;</p>	Janar e në vazhdim 2024	<p>Kompani/biznese dhe botën akademike, për të rritur ndërgjegjësimin mbi rolin dhe rëndësinë e standardeve në produkte, shërbimet dhe në tregt;</p> <p>Konsumatorë që kontrollojnë skadencën e produkteve dhe me cilat standarde janë prodhuar produktet që ata shërbehen;</p> <p>Kërkesa në rritje për pjesëmarrje në Komitetet Teknike të DPS;</p> <p>Më shumë informacion e transparencë në proceset e hartimit dhe miratimit të standardeve shqiptare.</p> <p>Realizimi i shitjes se standardeve, mbajtja e rregjistrave dhe funksionimi i database-s se re per shitjen e standardeve;</p> <p>Rishikimi i procedurave të punës lidhur me shitjen e standardeve dhe komunikimet me qytetarët dhe biznesin për standarde.</p>	DÇLMP



Programi Vjetor i Punës - DPS

Versioni 03

Faqa 1/8

V. Plotësimi i detyrimeve si Affiliate në CEN&CENELEC dhe antarësimi i DPS me të drejta të plota në CEN&CENELEC	<p>Zbatimi i Marrëveshjeve ekzistuese (dhe të reja, nëse do ketë) me CEN&CENELEC mbi statusin e organizmave affiliate në këto organizma.</p> <p>Evidentimi i cdo procesi dhe funksionimi të punës në DPS, vecanërisht ato që lidhen me kriteret e CEN&CENELEC për anëtarësim me të drejta të plota në këto organizma;</p> <p>Komunikimi me CCMC për ecurinë e procesit të anëtarësimit të DPS me të drejta të plota në CEN&CLC.</p>	Janar e në vazhdim 2024	<p>Funksionimi i DPS si organi i vetëm kombëtar për standardizimin sipas strukturës dhe kërkesave të CEN&CENELEC</p> <p>Plotësimi i masave korigjuese të lëna në raportin e auditit të CEN&CLC, dakordësuar edhe me KE për t'u realizuar deri në fund të 2024). Përputhja me kërkesat e dhëna në Guidën 20 e 22/2018 të CEN&CENELEC.</p>	DÇLMP dhe DS
VI. Pjesëmarrja në eventet europiane e ndërkombëtare të standardizimit dhe forcimi i kapaciteteve të DPS nëpërmjet trajnimeve të stafit. Pjesëmarrja e Bordit Drejtues në Asambletë e Përgjithshme në nivel European e Ndërkombëtar dhe evenete të tjera.	Pjesëmarrja në Asambletë e Përgjithshme të CEN, CENELEC, ETSI, ISO, IEC, në takimet vjetore të PR, mbledhjet e Komiteve Teknikë të CEN, CENELEC, ETSI, ISO, IEC dhe trajnime të stafit nëpërmjet seminareve të organizuara nga këto organizma dhe jo vetëm. Puna për mbarëvajtjen e projektit të UNIDO, si dhe takimet e punës së WP6 të UNECE, etj, si dhe pjesëmarrja e Bordit Drejtues të DPS në takimet dhe ventet europiane e ndërkombëtare.	Gjatë vitit 2023	Përfaqësimi i vendit në nivel europian e ndërkombëtar, vazhdimi i basëhkëpunimit me homologët dhe staf më i kualifikuar; sigurimi i progresit nëpërmjet përfshirjes në projekte dhe grupet e përbashkëta të punës në nivel rajonal e më gjerë	DPS



Programi Vjetor i Punës - DPS

Versioni 03

Faqa 1/8

Përfaqësimi i institucionit dhe kërkesat për përfshirjen e DPS në projektet/iniciativat evropiane e ndërkombëtare me interes për fushën e standardizimit në vend				
VII. Planifikimi i Buxhetit të vitit 2024 sipas PBA 2022-2024. Ndjekja dhe realizimi i te gjithe procedurave per pergatitjen e PBA ne te gjitha fazat Ndjekja e realizimit te treguesve, nëpërmjet rakordimit me MEKI dhe Degën e Thesarit Tiranë	<ul style="list-style-type: none">- Planifikimi i fondeve te nevojshme per mbarevajtjen e funksionimin e institucionit , mbështetur në legjislacionin në fuqi.- Sigurimi i një administrimi sa me te mire te fondeve buxhetore te celura per cdo artikull- Rakordimi me MFE dhe Degën e Thesarit për realizimin e treguesve të buxh. të planifikuar te shpenzimeve- Ndjekja e realizimit te te ardhurave nga shitja e standardeve dhe rakordimi me thesin	<p>Janar–Dhjetor 2024</p> <p>Cdo 4 mujor</p> <p>Cdo muaj</p>	<ul style="list-style-type: none">- Dergimi në MEKI i detajimit te buxhetit per vitin aktual dhe PBA 3 vjecare- Raportimi ne MEKI per monitorimin e buxhetit;- Pasqyrat e perfomances per produktet buxhetore dhe kostot perkatese-Pergatitja dhe dergimi ne MEKI i limiteve mujore te shpenzimeve per vitin-Pasqyrat e realizimit te shpenzimeve dhe rakordimi ne degen e thesarit-Pasqyrat e realizimit te te ardhurave dhe rakordimi me degen e thesarit	DÇLMP - Sektori/OBT,Shitjes se Standardeve dhe Sherbimeve
VIII. Nxjerra e bilancit kontabël vjetor të DPS	<ul style="list-style-type: none">- Regjistrimi e kuadrimi i veprimeve financiare në ditarët analistikë te shpenzimeve- Përgatitja e pasqyrave përbledhëse të veprimeve kontabël.- Sigurimi dhe kontrolli i gjithe procedurave per mireadministrimin e	<p>Janar–Dhjetor 2024</p> <p>Cdo fund viti</p>	<ul style="list-style-type: none">- Pasqyrat financiare te DPS per vitin 2023 (Bilanci dhe rezulati finanziar) duke respektuar afatet ligjore- Pasqyrat përbledhëse sipas llogarive kontabile- Evidencat financiare- Pasqyra e realizimit të investimeve- Pasqyrat e shpenzimeve valutore	DÇLMP Sektori/OBT,Shitjes se Standardeve dhe Sherbimeve



Programi Vjetor i Punës - DPS

Versioni 03

Faqa 1/8

	<p>aktiveve dhe pasurise materiale ne institucion.</p> <ul style="list-style-type: none">- Përgatitja brenda afateve të miratuar të listë pagesave mujore, listë pagesave të sigurimeve shoqërore dhe pasqyrimi i veprimeve në librin e pagës për vitin 2024	Cdo muaj	<ul style="list-style-type: none">- Inventarizimi i pasurisë dhe përgatitja e pasqyrave personale dhe përbledhëse te aktiveve ne perdonim te punonjesve dhe ne magazine- Pergatitja i borderove dhe liste pagesave te sigurimeve shoqerore ne sistemin HRMIS- Përgatitja e librit të pagave për vitin 2024- Perpilimi sipas kerkesave per vertetim pagash per perfitim e pensionit te plequerise	
IX. Menaxhimi i burimeve njerëzore, trajnime për ngritjen e kapaciteteve të stafit, ne perputhje me ligjin 152/2013, "Per nepunesin civil" të ndryshuar dhe akteve të tjera në zbatim të tij	<ul style="list-style-type: none">- Perditesimi i dosjeve te personelit- Vlerësimet individuale, te ndermjetme /perfundimtar të punonjësve,- Trajnimi i punonjësve brënda dhe jashte vendit.- Ndjekja e procedurave per largime/rekrutime te punonjesve	Në vazhdimësi 2 herë në vit	<ul style="list-style-type: none">- Dosjet e personelit ne sistemin HRMSdhe raportimi i ndryshimeve perkatese- Plotesimi i evidencave per BNJ sipas kerkesave te DAP- Regjistrimi on line i punonjesve sipas fushave te interesit ne linkun e trajnimeve te ASPA-s	DÇLMP Sektori/OBT, Shitje se Standardeve dhe Sherbimeve
X. Realizimi i prokurimeve dhe shërbimeve për vitin 2024	<ul style="list-style-type: none">- Përcaktimi i nevojave të DPS për blerje e shërbime dhe planifikimi mbi këtë bazë i prokurimeve sipas regjistrat të parashikimeve të prokurimeve publike.- Zbatimi i ligjshmërisë në fushën e prokurimeve dhe ndjekjen e procedurave- Monitorimi per realizimin e kontratave te investimeve	Janar-Dhjetor 2024	<ul style="list-style-type: none">- Regjistri i parashikimit te prokurimeve publike ne faqen e APP.- Përgatitja e dokumentacionit përkatës për blerjet me vlerë të vogël sipas udhëzimeve të Agjensisë së Prokurimit Publik- Raportimi ne regjistrin e realizimit te PP	DÇLMP Sektori/OBT, Shitje se Standardeve dhe Sherbimeve

**Shënim:**

DPS – Drejtoria e Pergjithshme e Standardizimit;

DÇLMP – Drejtoria e Çeshtjeve Ligjore dhe Mardheniet me Palet;

DS – Drejtoria e Standardeve

BD – Bordi Drejtues;

BT – Bordi Teknik

KT – Komiteti Teknik;

SMS – Sistemi Menaxhimit të Standardeve

CEN – Komiteti European për Standardizimin;

CENELEC - Komiteti European për Standardizimin në fushën e Elektroteknikës;

ETSI – Instituti European i Standardeve të Telekomunikacionit;

ISO – Organizata Ndërkombëtare e Standardeve;

IEC – Organizata Ndërkombëtare e Standardeve të Elektroteknikës;

ITU – Njësia Ndërkombëtare e Telekomunikacionit.